

FOND PENSIONAL I OBLIGUAR TRIGLAV – SHTYLLA E DYTË

Sigurimi pensional i obliguar me financim kapital është sigurim i bazuar plotësisht në kapitalizimin e mjeteve. Nëpërmjet kësaj shtylle sigurohet realizimi i së drejtës së sigurimit pensional në rast moshe, d.m.th. paguhet pension pleqërie (përveç pensionit nga shtylla e parë).

FOND PENSIONAL VULLNETAR TRIGLAV - SHTYLLA E TRETË

Sigurimi pensional vullnetar është sigurim i bazuar në kapitalizimin e mjeteve mbi bazë vullnetare. Në të mund të përfshihen të gjithë personat që duan të ofrojnë siguri materiale më të mirë përveç sigurimit të obliguar, si dhe ata që nuk janë të mbuluar nga sigurimi i obliguar.

SIGURIM PENSIONAL VULLNETAR PËR TË PUNËSUAR DHE ANËTARË

Një praktikë e zakonshme në shumë vende evropiane është ekzistenca e skemave të pensioneve profesionale, përmes së cilave punëdhënësit ose shoqatat e qytetarëve organizojnë dhe financojnë sigurim shtesë pensional për punonjësit e tyre, gjegjësisht anëtarët.

SHTYLLA E DYTË – FOND PENSIONAL I OBLIGUAR TRIGLAV

SIGURIM PENSIONAL INDIVIDUAL

Pse është përfshirë sigurimi pensional shtesë?

Qëllimi kryesor i sistemit të reformuar pensional është kujdesi dhe mbrojtja e interesave të secilit prej anëtarëve të tij, duke siguruar qëndrueshmëri afatgjatë të sistemit pensional dhe siguri të të siguruarve.

1. **Sigurimi pensional i obliguar** dhe invalidor në bazë të solidaritetit të gjeneratave (shtylla e parë) është sigurim i organizuar sipas parimit të financimit aktual (pay-as-you-go), që do të thotë se i siguruari aktual paguan për pensionistët aktualë. Për këtë sigurim kujdeset Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor. Nëpërmjet kësaj shtylle sigurohet realizimi i të drejtave të sigurimit pensional dhe invalidor në rast pleqërie, invaliditeti dhe vdekje, që do të thotë se paguhet një pjesë e pensionit të pleqërisë, pensionit për invaliditet, pensionit familjar, si edhe shumë më e ulët e pensionit.

2. **Sigurim pensional i obliguar me financim kapital (shtylla e dytë)** është sigurim i bazuar në kapitalizimin e mjeteve, ku ekziston një marrëdhënie e ngushtë dhe varësi midis vëllimit të fondeve të investuara - kontributeve dhe përfitimeve të ardhshme të pensioneve, të cilat realizohen nga çdo person. Gjegjësisht, ky lloj sigurimi bazohet në parimin e mbledhjes së fondeve duke paguar kontribute në llogaritë individuale. Këto fonde investohen më tej dhe fitimi, i zvogëluar nga kostot operative të sistemit, i shtohet fondeve në llogaritë individuale. Nëpërmjet kësaj shtylle sigurohet realizimi i të drejtës së sigurimit pensional në rast moshe, d.m.th. paguhet pension pleqërie (përveç pensionit nga shtylla e parë). Çdo i siguruar mund të zgjedhë vetëm një fond pensional të obliguar. Shuma e kontributit që transferohet në fondin e detyrueshëm pensional është 6% e pagës bruto, dhe në Fondin e SPIM kontributi mbetet në shumën 12,8% nga paga bruto.

3. **Sigurimi pensional vullnetar me financim kapital (shtylla e tretë)** është sigurim i bazuar në kapitalizimin e mjeteve, mbi një bazë vullnetare. Në të mund të përfshihen të gjithë personat që duan të kenë siguri më të mirë materiale përveç sigurimit të obliguar, si

dhe ata që nuk janë të mbuluar nga sigurimi i obliguar (në shtyllën e parë dhe të dytë). Për më tepër, me shtyllën e tretë mundësohet dhe krijimi dhe financimi i skemave profesionale pensionale. Çdo i siguruar mund të ketë një llogari vullnetare individuale dhe profesionale në një fond pensional vullnetar. Fondet e investuara, investohen në përputhje me rregulloret ligjore të vendosura në mënyrë rigorozë, të cilat sigurojnë mbrojtje më të lartë të interesave të të siguruarve dhe pasurive të tyre. Për anëtarët e shtyllës së tretë nuk ka asnjë kufizim në lidhje me shumën dhe frekuencën e pagesës së kontributit vullnetar.

CILAT JANË GARANCITË PËR SIGURI?

Mjetet e investuara në fondet private me financim kapital, janë investuar në përputhje me rregulloret ligjore të vendosura në mënyrë rigorozë, të cilat sigurojnë mbrojtjen më të lartë të interesave të anëtarëve dhe mjeteve të tyre. Në fondet private pensionale të obliguara, çdo anëtar ka llogarinë e tij individuale, në të cilën ruhen fondet nga kontributet që secili anëtar ndan nga paga e tij/e saj. Mjetet e ndara nga paga, së bashku me të ardhurat e investimit të tyre, hyjnë në formimin e shumës së pensionit. Faktorë që kontribuojnë në garantimin e sigurisë së mjeteve në fondet private: Mjetet e fondeve pensionale private janë të ndara nga shoqëritë që i administrojnë ato dhe mbahen nga të ashtuquajturit kujdestarë të pasurisë së fondeve pensionale; Rregullat për investimin e mjeteve nga shtylla e dytë dhe e tretë janë të përcaktuara në mënyrë rigorozë; Në rast mashtrimi, apo aktiviteti kriminal, ku si pasojë mjetet e fondit pensional të obliguar do të shterohen, është parashikuar një mbrojtje e përcaktuar saktësisht, d.m.th. sigurohet nga buxheti i shtetit për të bërë një pagesë në fondin pensional të obliguar në shumën prej 80% të humbjes;

Janë parashikuar kontroll i vazhdueshëm i institucioneve të sistemit pensional dhe gjopa të larta për operacione të paligjshme.

Kujdestar i pronës së Fondit Pensional Triglav është Banka Komerciale SHA Shkup

SI TË ANËTARËSOHEM NË FONDIN PENSIONAL TË HAPUR TË OBLIGUAR TRIGLAV?

Anëtarët e Fondit pensional të obliguar Triglav mund të jenë personat e siguarur që janë të mbuluar detyrimisht nga sigurimi pensional i obliguar me financim kapital dhe personat e siguarur, të cilët sipas zgjedhjes së tyre do të përfshihen në sigurimin pensional të obliguar me financim kapital, në përputhje me Ligjin për Sigurimin e Financimit Kapital Pensional të Obliguar dhe Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor dhe Fondit pensional të obliguar Triglav duke lidhur një marrëveshje anëtarësie.

Një person i siguarur mund të fitojë anëtarësim në Fondin Pensional të Obliguar në dy mënyra:

me nënshkrimin e një kontrate për anëtarësim në fond dhe me regjistrim në Regjistrin e anëtarëve, të mbajtur nga Agjencia,

me kalimin në Fondin pensional të obliguar Triglav me zgjedhje të rastësishme nga ana e Agjencisë, d.m.th. nga FONDI i SPIM, në rast se i siguarur, i cili është i detyruar të bëhet anëtar i një fondi pensional të obliguar, nuk ka nënshkruar një kontratë anëtarësie në periudhën e zgjedhjes së një fondi pensional të obliguar

Një i siguarur mund të jetë anëtar vetëm i një Fondi pensional të obliguar dhe në atë fond pensional mund të ketë vetëm një llogari.

I siguaruari, i cili për herë të parë nënshkruan një kontratë për anëtarësim në Fondin pensional të obliguar Triglav dhe nuk ka qenë deri atëherë anëtar i ndonjë Fondi pensional të obliguar, ka të drejtë të prishjes së njëanshme të kontratës, nëpërmjet një deklarate me shkrim të paraqitur në Shoqërinë Pensionale Triglav në afat prej 8 ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit. Pas skadimit të afatit prej 8 ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës, i siguaruari fiton anëtarësimin në fondin pensional të obliguar dhe

Kompania e Menaxhimit krijon një llogari individuale për anëtarin që ka nënshkruar kontratën.

Një person i siguruar, i cili është i mbuluar në sigurimin e obliguar me financim kapital, mund të lidhë kontratën për anëtarësim në Fondin pensional të obliguar Triglav brenda tre muajve të punësimit, d.m.th. aderimin në sigurimin pensional invalidor të obliguar.

Pas punësimit, gjegjësisht anëtarësimit në sigurimin pensional invalidor të obliguar, Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimit Pensional, MAPAS, kryen caktimin e përkohshëm të të siguruarit, ku Fondi pensional i obliguar Triglav, për anëtarin e caktuar përkohësisht krijon një nën-llogari individuale në kuadër të një llogarie të veçantë në Fondin pensional të obliguar Triglav.

Anëtari i Fondit pensional të obliguar Triglav mund të kalojë dhe të anëtarësohet lirisht në një tjetër Fond pensional të obliguar.

Një anëtar që ka një llogari individuale në Fondin pensional të obliguar Triglav, mund të kalojë në një tjetër fond pensional të obliguar, të menaxhuar nga ndonjë kompani tjetër duke nënshkruar një marrëveshje transferimi me kompaninë që menaxhon fondin pensional të obliguar në të cilin kalon, nënshkrim të një deklarate pajtimi, për kalim dhe pagesë të një kompensimi të duhur.

KONTROLL I PUNËS SË FONDIT

Politika investuese

Mjetet e Fondit pensional të obliguar Triglav investohen në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fushën e sigurimit pensional me financim kapital dhe strategjinë e investimeve dhe taktikat e investimeve, të miratuara nga Bordi i Drejtorëve të Shoqërisë së Administrimit dhe të aprovuara nga Bordi Mbikëqyrës.

Tregtimi me letra me vlerë i Fondit pensional të obliguar Triglav nga Shoqëria e Administrimit kryhet në tregje sekondare të rregulluara të kapitalit, tregje pa sportele dhe tregje primare, për instrumente që plotësojnë kërkesat e ligjit dhe rregulloreve të miratuara nga Agjencia për mbikëqyrja e financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS).

Shoqëria për administrim mund:

të lidhë marrëveshje për blerjen dhe shitjen e aksioneve në pronësi të fondit pensional të obliguar në rast të marrjes në dorëzim të shoqërisë aksionare përmes një oferte publike për blerje;

të blejë aksione të lëshuara nga shoqëri aksionare që përmbushin kërkesat e Rregullores për investimin e mjeteve të fondeve pensionale të obliguara, me një ofertë publike (emision shtesë i aksioneve);

të blejë letra me vlerë të borxhit që plotësojnë kërkesat për lëshuesin dhe nxjerrjen nga Rregullorja për investimin e mjeteve të fondeve pensionale të obliguara, në rast të një oferte publike; dhe

të blejë dokumente të aksioneve dhe të paraqesë një kërkesë për blerje të dokumenteve të aksioneve direkt nga/ tek kompania që administron fondet e investimeve të hapura, të lëshuara përmes një oferte publike.

Mjetet e Fondit pensional të obliguar Triglav mund të investohen vetëm në llojet e mëposhtme të instrumenteve:

- a) depozita në banka, të cilat kanë licencë të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, nëse kanë interesa;
- b) obligacione dhe letra të tjera me vlerë të lëshuara ose të garantuara nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë;
- c) certifikata për depozita, fatura komerciale dhe obligacione të lëshuara ose të garantuara nga banka, të cilat kanë licencë të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë;

d) letra me vlerë të mbështetur në hipotekë, të lëshuara nga banka, të cilat kanë licencë të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë;

e) obligacione dhe letra me vlerë të tjera, të lëshuara ose të garantuara nga Republika e Maqedonisë në tregun e brendshëm;

f) aksione të shoqërive aksionare vendase, të cilat nuk janë fonde investimi të mbyllura, të lëshuara në bazë të aprovimit nga Komisioni i Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë dhe të listuara në tregun zyrtar, ose të tregtuara në tregun e shoqërive aksionare, me detyrime të veçanta raportimi brenda tregut të rregullt të bursës, ose në një treg tjetër të organizuar të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë, të kontrolluar nga Komisioni;

g) obligacione, të lëshuara në bazë të miratimit nga Komisioni i Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë, të listuara në tregun zyrtar të bursës së letrave me vlerë afatgjata, ose në një treg tjetër të organizuar të letrave me vlerë në Republikën e Maqedonisë, të kontrolluar nga Komisioni; lëshuar nga njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe nga shoqëritë aksionare vendase, të cilat nuk janë banka;

h) faturat tregtare të lëshuara nga shoqëritë aksionare të klasit të parë në Republikën e Maqedonisë, të cilat nuk janë banka;

i) dokumente për pjesën dhe aksionet e fondeve të investimeve të hapura, fondeve të investimeve të mbyllura dhe fondeve private të investimeve, të regjistruara në Komisionin e Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë, ku mjetet e fondeve private të investimeve, investohen në aksione dhe pjesë në ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë, të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrjet;

j) obligacione dhe letra të tjera me vlerë të lëshuara nga qeveritë e huaja dhe bankat qendrore të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe OECD;

n) letra me vlerë të borxhit, të cilat kanë një rejting të rekomanduar për investime sipas agjencive ndërkombëtare të vlerësimit të kredisë, të lëshuara nga kompani jo-shtetërore, kompani të huaja ose banka nga vendet anëtare të BE-së dhe OECD-së;

l) aksione, të lëshuara nga kompani ose banka të huaja, të cilat kanë një vlerësim të rekomanduar për investime sipas agjencive ndërkombëtare të vlerësimit të kredisë, të cilat tregtohen në bursat kryesore të aksioneve në vendet anëtare të BE-së dhe OECD-së;

m) dokument për kapitalin, aksionet dhe instrumente të tjerë, të lëshuar nga fondet e autorizuara të investimeve me seli në një shtet anëtar të BE-së ose OECD-së, të cilët kanë investuar kryesisht në instrumente të listuara në bursat e atyre vendeve dhe politika e tyre e investimeve lejon përdorimin e instrumenteve derivate deri në 20% të mjeteve të fondit të investimeve, vetëm për qëllime të mbrojtjes së mjeteve dhe detyrimeve të fondit të investimeve, ose për arritje më efektive të objektivave të politikës së investimeve të fondeve të investimeve, të cilat monitorojnë performancën e një indeksi të caktuar;

l) një lloj tjetër investimi, në përputhje me aktet e Agjencisë, me kusht që të mos jetë në kundërshtim me Ligjin për Sigurimin e Pensionit të Obliguar me Financim Kapital.

TË DHËNA KRYESORE PËR AKTIVITETET INVESTUESE TË FONDIT PENSIONAL TË HAPUR TË OBLIGUAR TRIGLAV- SHKUP PËR PERIUDHËN 01.04.2019-31.12.2019

MENAXHIMI ME RREZIQE

Investimi i mjeteve të Fondit pensional të obliguar Triglav bëhet në mënyrë që të arrihen të ardhura më të larta vetëm në dobi të anëtarëve dhe anëtarëve të pensionuar të Fondit pensional të obliguar Triglav dhe përmes diversifikimit dhe analizës financiare, minimizohet rreziku i humbjeve:

- a) që do të ndodhin për shkak të mospagimit të lëshuesit ose palës tjetër kontraktuese;
- b) që rrjedhin nga ndikimi në tregjet e brendshme dhe të huaja financiare;
- c) në vlerën reale të mjeteve të fondit pensional të obliguar për shkak të inflacionit; dhe
- d) të cilat janë pasojë e shitjes së mjeteve të fondit pensional të obliguar për shkak të sigurimit të likuiditetit të fondit pensional të obliguar.

KOMPENSIME

Anëtarët, të cilët kanë një llogari individuale në Fondin pensional të obliguar Triglav, paguajnë kompensimet e mëposhtme:

- kompensim nga kontributet, si përqindje e çdo kontributi të paguar në Fondin pensional të obliguar Triglav, në shumë prej 2% të kontributeve të paguara, përpara se të shndërrohen në njësi kontabël,
- kompensim për menaxhimin e mjeteve - tarifë mujore në vlerë prej 0,03% të vlerës së mjeteve totale neto të secilës llogari individuale në fondin e pensionit.

Kompensimi për menaxhimin e mjeteve është i njëjtë për të gjithë anëtarët e Fondit pensional të obliguar Triglav.

Kompensimi paguhet gjithashtu dhe për transferimin e një anëtari të Fondit pensional të obliguar Triglav në një fond tjetër pensioni.

Shoqëria administruese nga përfituesit e pensioneve nga Fondi pensional i obliguar Triglav, me tërheqje të programuara paguan një tarifë mujore në shumë prej 0,03% të vlerës së mjeteve totale neto të çdo llogarie individuale në fondin pensional (tarifë për menaxhimin me mjete).

Shuma e tarifës për transferim varet nga koha ndërmjet datës kur i siguruari fitoi statusin e anëtarit të fondit ekzistues pensional të obliguar, deri në datën e transferimit të fondeve në llogarinë individuale në fondin e ardhshëm pensional të obliguar. Për më pak se dy vjet (720 ditë) tarifa është 15 euro në kundërvlerë me denarë, ndërsa për më shumë se dy vjet tarifa nuk paguhet.

TË DHËNA PËR FONDIN PENSIONAL TË HAPUR TË OBLIGUAR TRIGLAV REZULTATE, TË ARDHURA NGA INVESTIMET DHE KOMPENSIMET

SHËRBIME PËR ANËTARËT DHE ANËTARËT E PENSIONUAR

NDRYSHIM I TË DHËNAVE PERSONALE

Kompania dhe agjenti janë të detyruar të sigurojnë konfidencialitet dhe mbrojtje të të dhënave personale të anëtarit në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në rast të ndryshimit të të dhënave personale, anëtari është i detyruar të informojë kompaninë, në mënyrë që të dhënat personale të azhurnohen.

REALIZIM I TË DREJTAVE NGA SIGURIMI PENSIONAL I OBLIGUAR

Mjetet nga llogaria e anëtarëve dhe pensionistëve të Fondit pensional të obliguar Triglav janë pjesë e pasurisë së tyre personale.

Të drejtat për përdorim dhe disponim të atyre fondeve nuk mund të ushtrohen deri në ditën e pensionit, vdekjes ose invaliditetit të anëtarit në përputhje me ligjin.

PAGIMI I PENSIONIT

Kur një anëtar i Fondit pensional të obliguar Triglav fiton të drejtën për pension pleqërie në përputhje me Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, ai/ajo përcakton mënyrën e pagesës së fondeve të grumbulluara në llogarinë e tij/saj, dhe janë të mundshme disa zgjidhje:

- Blerja e një anuiteti pensional (anitet i drejtpërdrejt i përhershëm), i cili paguhet deri në fund të jetës,
- tërheqje të programuara, ose
- kombinim i opsioneve të përmendura më sipër.

Për pagesën e mjeteve nga një llogari individuale përmes një anuiteti pensioni të drejtpërdrejt të përhershëm, anëtari nënshkruan një policë për anitet me një kompani sigurimesh, ndërsa për pagesën e mjeteve përmes tërheqjeve të programuara, anëtari nënshkruan një marrëveshje për tërheqje të programuara me një kompani pensionale. Në rast të pagesës së mjeteve përmes një kombinimi të tërheqjeve të programuara të përkohshme dhe pensionit të shtyrë për jetën, anëtari nënshkruan një kontratë me një kompani pensionale dhe lidh një policë me një kompani sigurimesh.

Polica e anitetit është një marrëveshje që nuk priset. Kompania e sigurimeve nuk guxon të anulojë policën për anitet as edhe në rast të pëlqimit të shfrytëzuesit të pensionit.

Shfrytëzuesi i pensionit mund të zëvendësojë tërheqjet e programuara të përhershme të siguruara nga kompania pensionale me përdorimin e mjeteve të mbetura në dispozicion nga llogaria individuale, për të blerë tërheqje të programuara të përhershme nga një kompani tjetër pensionale, blerje anitet të përhershëm nga një kompani sigurimesh ose për të blerë tërheqje të përkohshme të programuara, të kombinuara me një anitet vjetor të shtyrë.

Në rast se shfrytëzuesi i pensionit zgjedh tërheqje të programuara të përkohshme në kombinim me një anitet të përhershëm të shtyrë, ai në çdo kohë mund të zëvendësojë tërheqjet e programuara të përkohshme të siguruara nga një kompani pensionale, me shfrytëzimin e mjeteve të mbetura në dispozicion nga një llogari individuale për blerje të tërheqjeve të programuara të përkohshme nga një kompani tjetër pensionale për periudhën e mbetur, por nuk mund të anulojë policën për anitet të shtyrë.

Një kompani sigurimesh dhe një kompani pensionale nuk duhet të refuzojnë lidhjen e një kontrate, ose police për anitet me një anëtar që ka zgjedhur ofertën e tij.

Shfrytëzuesi i pensionit nga shtylla e parë mund të shtyjë realizimin e pensionit nga shtylla e dytë për një maksimum prej 3 vjetësh nga dita e fitimit të së drejtës së pensionit të pleqërisë nga shtylla e parë. Pas skadimit të kësaj periudhe, shfrytëzuesi i pensionit duhet të zgjedhë një nga llojet e përshkruara të pagesës së pensionit nga shtylla e dytë. Nëse nuk e bën këtë, ai bëhet përfitues i një pensioni të shtyllës së dytë përmes tërheqjeve të programuara gjatë gjithë jetës nga fondi pensional i obliguar, ku ai ka një llogari individuale.

PENSIONE FAMILJARE

Në rast të vdekjes së një anëtari të Fondit pensional të obliguar Triglav, anëtarët e familjes së të cilët kanë të drejtë për pension familjar, Shoqëria administruese llogarit pensionin familjar përmes tërheqjeve të programuara sipas rregullave të mëposhtme:

a) Nëse ka të paktën një shfrytëzues që do të përdorë pensionin familjar gjithë jetën, llogaritet një pension individual i përhershëm përmes tërheqjes së programuar për shfrytëzuesin më të ri që do të përdorë pensionin e përhershëm.

b) Nëse nuk ka shfrytëzues që do të përdorin pensionin familjar të përhershëm, llogaritet pension individual i përkohshëm përmes tërheqjeve të programuara për shfrytëzuesin më të ri, i cili do ta përdorë pensionin përkohësisht.

Në të dy rastet, nëse pensioni familjar i llogaritur në këtë mënyrë është më i madh ose i barabartë me pensionin e llogaritur nga Fondi i SPIM, atëherë bartësi i të drejtës për pension familjar ka të drejtë të zgjedhë nëse:

- do të mbajë mjetet në llogarinë individuale të anëtarit dhe do të anulojë pensionin familjar nga shtylla e parë, pas së cilës Shoqëria administruese fillon me pagesën e tërheqjeve të programuara;
- Mjetet nga llogaria individuale e anëtarit do të transferohen në SPIM nga ku do të paguhet pensioni familjar.

c) Nëse anëtari i vdekur i Fondit pensional të obliguar Triglav nuk ka anëtarë të familjes, të cilët kanë të drejtë për pension familjar sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, fondet nga llogaria e atij anëtari bëhen pjesë e pasurisë së trashëgimlënësit dhe ato mjete trajtohen sipas Ligjit për trashëgimi.

PENSION INVALIDOR

Shoqëria administruese llogarit një pension invaliditeti si një pension të përjetshëm individual, përmes tërheqjeve të programuara dhe nëse pensioni i llogaritur në këtë mënyrë është më i madh ose i barabartë me pensionin e llogaritur nga Fondi i SPIM, atëherë bartësi i të drejtës për një pension familjar në shtyllën e dytë ka të drejtë të zgjedhë:

- të mbajë mjetet në llogarinë individuale të anëtarit dhe të anulojë pensionin invalidor nga shtylla e parë, pas së cilës Shoqëria administruese fillon me pagesën e tërheqjeve të programuara;
- mjetet nga llogaria individuale e anëtarit do të transferohen në Fondin e SPIM nga ku do të paguhet pensioni familjar.

Nëse pensioni i llogaritur familjar ose invalidor nga shtylla e dytë është më i vogël se shuma e pensionit nga shtylla e parë, mjetet transferohen në Fondin e SPIM, nga ku bëhet pagesa familjes, pra pensioni invalidor.

Kur një anëtar, ose përkohësisht i siguruar nga Fondi pensional i obliguar Triglav fiton të drejtën për pension invalidor të përkohshme, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor, pensioni i përkohshëm invalidor paguhet nga Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë, dhe mjetet nga llogaria individuale e anëtarit mbeten në fondin

pensional të obliguar Triglav, derisa anëtari të ketë të drejtën e pensionit të pleqërisë, invalidor ose familjar.

PO NË RAST SE NUK KENI PËRVOJË PUNE TË MJAFTUESHËM?

Kur një anëtar i fondit pensional të obliguar Triglav nuk do të fitojnë të drejtën për një pension pleqërie, sipas Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, sepse ai nuk ka kryer të paktën 15 vjet përvojë pune për pension, ai mund të blejë një anuitet mujor pensioni, nëse shuma e anuitetit është e barabartë ose më e madhe se 40% e shumës më të ulët të pensionit. Kur shuma e llogaritur e anuitetit të pensionit është më e vogël se 40% e shumës minimale të pensionit, Fondi pensional i obliguar Triglav menjëherë do t'i paguajë mjetet e grumbulluara në llogarinë e anëtarit.

Blerja e anuitetit pensional dhe pagesa e mjeteve të grumbulluara mund të bëhet pasi të jetë mbushur mosha 65 vjeç.

FORMULARË

1. [Kërkesë për gjendjen e llogarisë](#)
2. [Formular për të dhënat personale të një anëtar të zgjedhur](#)
3. [Kërkesa për azhurnimin e të dhënave personale](#)
4. [Formular për ankesë](#)
5. [Formular për njoftim të një anëtar](#)
6. [Deklaratë për pëlqim – trashëgimtarë](#)
7. [Kërkesë për pagesë të mjeteve në bazë të trashëgimisë](#)
8. [Kërkesë për bilancin e llogarisë për një anëtar të vdekur për fillimin e një procedure testamenti](#)
9. [Deklaratë për pëlqim për pagimin e pensionit të shtyllës së dytë](#)
10. [Kërkesë për llojin e pagesës së pensionit - nëse ai/ajo nuk ushtron të drejtën për pension të shtyllës së parë](#)
11. [Deklaratë për anulimin e pensionit të shtyllës së parë](#)
12. [Kërkesa nga një anëtar për një lloj pagese nga shtylla e dytë](#)
13. [Deklaratë për pëlqim për përpunimin e të dhënave personale](#)

ANKESA

Ruajtja e cilësisë së punës dhe ruajtja e besimit të anëtarëve është një përparësi kryesore në punën tonë, në këtë drejtim Shoqëria Pensionale Triglav SHA Shkup ka krijuar një procedurë për pranim, përpunim dhe përgjigje ndaj të gjitha kërkesave, vërejtjeve, komenteve ose ankesave.

Nëse keni vërejtje, komente ose ankesa në lidhje me ndonjë pjesë të punës sonë, pa dallim nëse pakënaqësia juaj ka të bëjë me sistemin e sigurimit pensional në përgjithësi dhe mënyrën se si funksionon Shoqëria apo konkretisht me veprimet e personave të caktuar të përfshirë në punën e Kompanisë, ose kompani të tjera të sigurimeve pensionale, ju lutemi na kontaktoni.

Ju lutemi plotësoni [Formularin për ankesa](#), nënshkruajeni vetë dhe dorëzoni në adresën e Shoqërisë (me postë, e-mail ose personalisht në ambientet tona).

Stafi ynë është gjithmonë në dispozicion për t'ju ndihmuar dhe do të shqyrtojë dhe përgjigjet për çdo ankesë të marrë sa më shpejt të jetë e mundur.

(Në përputhje me aktet e brendshme të Shoqërisë, Komisioni përgjegjës për ankesa duhet të marrë një vendim ose përfundim mbi ankesën specifike jo më vonë se 30 ditë nga marrja e saj)

Do të jetë kënaqësia jonë nëse mund ta përmirësojmë situatën.